

shqip

JESENICE, SHTËPIA IME E RE

Është mirë të dish:
Broshurë informuese për emigrantët

KOPJE FALAS – MERRMË ME VETE!

PËRMBAJTJE

- Shërbimet administrative
- Shërbimet sociale
- Sigurimi shëndetësor
- Si të gjeni një mjek
- Arsimi
- Punësimi
- Sporte, kulturë dhe jetë sociale
- Kurse të gjuhës sllovene
- Ndihmë për komunikimin
- Policia, zjarrfikësit, shërbimi i urgjencës

Të nderuar emigrantë,

Kjo broshurë ka për qëllim t'ju lehtësojë hapat tuaj të parë në një mjedis të ri. Ajo përmban informacione për ndihmën e disponueshme në qendrat e ndihmës sociale dhe organizata të tjera, për regjistrimin e fëmijëve në kopsht ose shkollë, si dhe për përfitimin e sigurimeve shëndetësore dhe gjetjen e një mjeku. Gjithashtu, do të gjeni informacione bazike për gjetjen e një pune dhe mësimin e sllovenishtes, aktivitetet e organizuara nga shoqata të kulturës dhe sportit dhe opsionet e disponueshme për të rinjtë, si dhe për vendet ku mund të gesh ndihmë me komunikimin.

Kjo broshurë është rezultat i aktiviteteve pilot të zhvilluara nga PlurAlps (INTERREG Alpine Space), një projekt transnational i fokusuar në kthimin e hapësirës alpine në një vend miqësor për emigrantët. Duke iu përgjigjur kërkesës nga partneri i projektit – Instituti i Planifikimit Urban i Republikës së Sllovenisë, bashkitë Jesenice, Kamnik dhe Postojna i janë bashkuar projektit dhe kanë nisur aktivitete pilot me synim krijimin e një mjedisi më përfshirës për emigrantët.

Ne shpresojmë që qëllimet tona të kenë pasur sukses. Urojmë të gjendeni mirë në mjedisin e ri dhe shpresojmë të bëheni pjesë aktive e tij.

Autorët

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE

Çfarë mund të bëj pranë njësisë administrative?

Pranë njësisë administrative ju mund të kujdeseni për çështje të tilla si leja e qëndrimit, regjistrimi i qëndrimit të përkohshëm/të përhershëm, lejet e veçanta të punës dhe qëndrimit (shih seksionin e Punësimit), martesat, certifikatat e lindjes, lejet e drejtimit, zëvendësimet e dokumenteve të humbura, etj.

Ju mund të aplikoni për leje të përkohshme qëndrimi vetëm nëse keni hyrë ligjërisht në Slloveni dhe gjithashtu duhet të përmbushni kushte të tjera (p.sh., të studioni ose punoni në Slloveni). Si rregull i përgjithshëm, për lejen fillestare duhet të aplikoni në konsullatën ose ambasadën e Republikës së Sllovenisë, ndërsa zgjatjet mund t'i kërkonti pranë njësisë suaj administrative vendore. Nëse zhvendoseni, njësia administrative duhet të njoftohet brenda 8 ditësh për adresën tuaj të re.

Për fëmijët e lindur në Slloveni, materniteti do t'i japë të gjitha të dhënat përkatëse njësisë administrative dhe certifikata e lindjes do të dërgohet në adresën tuaj. Foshnja nuk e përfiton që në lindje shtetësinë slovene. Që foshnja të fitojë të drejtën e lejes së qëndrimit, duhet të përgatiten dokumentet e nevojshme sa më shpejt të jetë e mundur në vendin e origjinës (vendin e prindërve). Foshnjës nuk përfiton sigurime shëndetësor deri në momentin e marrjes së lejes së qëndrimit.



Njësia administrative Jesenice / Upravna enota Jesenice
Cesta železarjev 6a, 4270 Jesenice

☎ (04) 585 1400, www.upravneenote.gov.si/jesenice

Jesenice

SHËRBIMET SOCIALE

Çfarë ndihme mund të ofrojë qendra e ndihmës sociale?

Mund të kontaktoni qendrën e ndihmës sociale në çdo kohë nëse keni një problem. Këshilluesit do t'ju ndihmojnë. Ata mund të ofrojnë asistencë financiare si dhe ndihmë për integrimin në komunitet, mbështetje për familjet dhe fëmijët, dhe këshillime për një shumëllojshmëri çështjesh.

Asistenca sociale fillestare i referohet bisedës së parë me një punonjës social, ku ju diskutoni lidhur me problemin tuaj dhe së bashku gjeni një zgjidhje. Ju do të merrni informacion në lidhje me llojet e disponueshme të ndihmës, si dhe mënyrës së përfitimit të saj, përfshirë këtu edhe asistencën financiare.

Si mund ta aksesoni asistencën financiare fillestare? Vizitoni qendrën gjatë orarit zyrtar të punës, për të realizuar bisedën e parë me punonjësin social. Nuk ka nevojë që të rezervoni një takim paraprakisht. Në raste emergjence ju gjithashtu mund të kërkonti ndihmë përtej orarit të punës, por vetëm gjatë orëve që institucioni qëndron i hapur.

Ndihmë personale do të thotë këshillim afatgjatë për të zgjidhur problemet tuaja në varësi të nevojave tuaja. Do t'ju caktohet një këshillues, i cili do t'ju ndihmojë në hartimin e planit për zgjidhjen e problemit dhe do t'ju udhëheqë në rrugën tuaj, duke ju ndihmuar të gjeni një zgjidhje dhe të organizoni jetën tuaj. Gjithashtu, ata do t'ju informojnë në lidhje me llojet e disponueshme të ndihmës për ju në nivel lokal, dhe asaj të ofruar nga organizata të tjera (Kryqi i Kuq, Caritas, etj.).



Këshillim familjar do të thotë ndihmë në marrëdhëniet familjare dhe kujdesin për fëmijën. Është e ngjashme me ndihmën personale, por këtu përfshihen më shumë anëtarë të familjes në këshillim.

Ndihma në shtëpi ofrohet për personat mbi moshën 65 vjeçare dhe ata të cilët nuk e kanë mundësinë të kujdesen për vetveten. Ajo përfshin ndihmën me punët e shtëpisë, kujdesin personal, vendosjen e kontakteve sociale, kujdesin ndaj çështjeve urgjente, etj.

Asistenca financiare: Ju mund të aplikoni për përfitime të fëmijëve, përfitime të asistencës sociale me para në dorë, mbështetje në të ardhura, tarifa të reduktuara për kopshtin, vakte të paguara për nxënësit e arsimit fillor dhe atij të mesëm, subvencionim qiraje, përjashtim nga pagesat e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor dhe/ose shërbime të asistencës sociale, etj.

Për më shumë informacion rreth të drejtave tuaja vizitoni:
<https://www.csd-slovenije.si/>.



Qendra e ndihmës sociale / Center za socialno delo Gorenjska, Enota Jesenice
 Cesta železarjev 4a, 4270 Jesenice

Jesenice

☎️ (04) 583 4600, www.csd-jesenice.si

SIGURIMI SHËNDETËSOR

Sigurimi shëndetësor mbulon shpenzimet tuaja në rast sëmundjeje, lëndimi apo çfarëdolloj nevojë tjetër mjekësore, duke garantuar sigurim mjekësor dhe shoqëror (për kohëzgjatjen e sëmundjes ose të lëndimit tuaj). Sigurimi shëndetësor në Slloveni është i detyrueshëm (sigurimi shëndetësor bazë) dhe vullnetar. Sigurimi shëndetësor bazë është i detyrueshëm për të gjithë personat rezidentë në Republikën e Sllovenisë. Zakonisht mbulohet dhe paguhet nga punëdhënësi. Ju jeni të detyruar ta mbulonit vetë veten tuaj me sigurim shëndetësor të detyrueshëm, nëse dëshironi të shtoni anëtarë të familjes në të ose nëse mbeteni të papunë dhe nuk përfitoni kompensim financiar. Në këtë rast, jeni të detyruar të dërgoni një formular M-DČ pranë Institutit të Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë.

Ndërsa sigurimi shëndetësor i detyrueshëm mbulon vetëm shpenzimet bazë të trajtimit, ne rekomandojmë zgjedhjen e sigurimit shëndetësor vullnetar për të garantuar mbulim të plotë të vlerës së shërbimeve mjekësore që nuk mbulohen plotësisht nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm.

Sigurimi shëndetësor i detyrueshëm është i nevojshëm përpara se të zgjidhni sigurimin shëndetësor vullnetar. Ju takon juve të zgjidhni të pajiseni me sigurim shëndetësor vullnetar, pranë cilësdo prej kompanive të disponueshme të sigurimeve, konkretisht Adriatic, Triglav ose Vzajemna.

Nëse nuk keni sigurim shëndetësor, gjithsesi gëzoni të drejtën për shërbimin e urgjencës mjekësore. Për çfarëdolloj shërbimesh të tjera, ju mund të kontaktoni klinikën pa pagesë për individët pa sigurim shëndetësor.

Jesenice

Instituti i Sigurimeve Shëndetësore / Zavod za zdravstveno zavarovanje
Slovenije, OE Kranj, Izpostava Jesenice
Cesta maršala Tita 78, 4270 Jesenice
☎️ (04) 583 3782, www.zzs.si/imenik

KOMPANITË E SIGURIMEVE:

VZAJEMNA zdravstvena zavarovalnica
Cesta maršala Tita 77, 4270 Jesenice
☎️ (04) 583 3830, www.vzajemna.si/sl/poslovalnice/poslovalnica-jesenice

ADRIATIC SLOVENICA d.d.
Cesta železarjev 2, 4270 Jesenice
☎️ (04) 583 7050, www.adriatic-slovenica.si/zavarovanje/zdravje

Zavarovalnica TRIGLAV d.d.
Delavska ulica 1, 4270 Jesenice
☎️ (04) 581 0500, www.triglavzdravje.si/sklenitev-zavarovanja/dopolnilno-zdravstveno-zavarovanje

SI TË GJENI NJË MJEK

Pasi të jeni pajisur me sigurimin shëndetësor të detyrueshëm, do t'ju duhet të zgjidhni një mjek familjeje me të cilin të konsultoheni në rast problemesh shëndetësore. Listën e mjekëve të disponueshëm e gjeni pranë qendrës shëndetësore më të afërt me ju. Qendra shëndetësore gjithashtu ka klinika për foshnjat, fëmijët në moshë shkolle, duke ofruar shërbime mjekësore dhe këshillim.

Përveç mjekut të familjes, ju mund të zgjidhni edhe një dentist ose gji-nekolog familjeje.

Qendrat shëndetësore gjithashtu ofrojnë shërbime këshillimi, të cilat japin informacione në lidhje me kujdesin ndaj shëndetit tuaj, ndjekjes së një diete të shëndetshme, të qëndruarit aktivë fizikisht, ruajtjes së një peshe të shëndetshme, jetesës pa vese të dëmshme (siç është pirja e duhanit, konsumimi i alkoolit), krijimin e marrëdhënieve të mira ndër-personale dhe menaxhimin e stresit. Të gjitha shërbimet e këshillimit dhe seminarët janë pa pagesë dhe të hapura për këdo që dëshiron të bëjë diçka të mirë për shëndetin e tij. Pyesni pranë qendrës suaj më të afërt për detajet.

Për shërbimin e urgjencës mjekësore, telefononi në numrin pa pagesë 112 ose vizitoni urgjencën, e cila qëndron e hapur 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Për të komunikuar me mjekët, mund të përdorni këtë fjalorth slllovenisht-shqip http://multilingualhealth.ff.uni-lj.si/MNZ_alban_ponatis_www_skupaj.pdf

Qendër shëndetësore / Zdravstveni dom Jesenice
Cesta maršala Tita 78, 4270 Jesenice

Jesenice

☎ (04) 586 8146, www.zd-jesenice.si

Spitali i përgjithshëm / Splošna bolnišnica Jesenice
Cesta maršala Tita 78, 4270 Jesenice

☎ (04) 586 8000, www.sb-je.si

Urgjenca / Urgentna ambulanta, Cesta maršala Tita 78, 4270 Jesenice

☎ (04) 586 8385, www.sb-je.si, www.zd-jesenice.si

Shërbime falas për personat pa sigurim shëndetësor

Klinika "Fajdiga" / Fajdigova Ambulanta

Gospovetska ulica 9, 4000 Kranj

☎ (04) 208 2208, www.fajdigova.si

ARSIMI

Ku, si dhe kur t'i regjistroni fëmijët në kopsht

Fëmija juaj mund të regjistrohet në kopsht nga mosha 11 muajsh e sipër. Sipas disponueshmërisë, fëmija juaj mund të regjistrohet në çdo moment të vitit. Për ta regjistruar, vizitoni kopshtin tuaj më të afërt, për të marrë formularin e regjistrimit dhe informacione të tjera. Meqë kopshti nuk është i detyrueshëm, përkundrejt ndjekjes paguhet një tarifë. Shuma varet nga kopshti dhe të ardhurat tuaja. Në qendrën e ndihmës sociale, ju mund të pyesni nëse keni të drejtë të përfitonit tarifë të reduktuar për frekuentimin e kopshtit. Aplikimi për një tarifë të reduktuar kopshti duhet të dorëzohet të paktën një muaj përpara se fëmija të fillojë kopshtin.

... për arsimin fillor

Arsimi fillor në Slloveni është i detyrueshëm për fëmijët e moshave ndërmjet 6 dhe 15 vjeç. Arsimi fillor ka 9 klasë. Fëmija juaj duhet të regjistrohet në klasë të parë të arsimit fillor në vitin kalendarik në të cilin ai mbush 6 vjeç. Regjistrimi në ciklin e arsimit fillor bëhet në muajin shkurt. Vizitoni shkollën tuaj filllore më të afërt për të mësuar më shumë në lidhje me regjistrimin dhe kurrikulën, duke përfshirë edhe fëmijët të cilët e kanë ndjekur më herët arsimin fillor. Informacioni në lidhje me tarifat e reduktuara për vaktin përpara drekës dhe për drekën është i disponueshëm në qendrën e ndihmës sociale.



... për arsimin e mesëm

Arsimi i mesëm ka 3 ose 4 klasë dhe përbëhet nga shkollat e mesme të përgjithshme (gimnazija), shkollat profesionale dhe ato teknike. Thirrjet për regjistrim publikohen në shkurt. Në të njëjtën kohë, shkollat zhvillojnë ditë të hapura për vizitorët ku të mund të mësoni më shumë rreth kurrikulës. Regjistrimi zhvillohet në mars. Nxënësit e arsimit të mesëm gjithashtu mund të kenë të drejtën e një tarife të reduktuar për vaktin e paradites.

Arsimi për të rritur

Jeni të rritur dhe kërkon ta përfundoni arsimin tuaj? Dëshironi të arsimoheni më tej? Keni disa opsione të disponueshme për të siguruar ose përfunduar arsimin formal si dhe për të marrë pjesë në programe të arsimit joformal, si për shembull seminare dhe takime rreth zhvillimit personal, fuqizimit të aftësive bazë, integritit më të thjeshtë në mjedisin lokal, etj. Keni mjaftueshëm aftësi dhe njohuri në një profesion specifik por ju mungon kualifikimi formal? Mund të regjistroheni në programin kombëtar të kualifikimit profesional (Nacionalna poklicna kvalifikacija, NPK), i cili përbën dhe rrugën më të shpejtë drejt profesionit të dëshiruar. Kontaktoni me strukturat e arsimit për të rritur në bashkinë tuaj. Ata do të jenë të gatshëm për këshilla dhe asistencë. Disa programe të arsimit për të rritur janë pa pagesë.

Disa programe të arsimit për të rritur gjithashtu janë të disponueshme në **Institutin e Republikës së Sllovenisë për Arsimin dhe Formimin Profesional** (Center RS za poklicno izobraževanje, <http://www.cpi.si/en/>) dhe në **Institutin e Studimeve të Biznesit** (Center za poslovno usposabljanje, <https://www.cpu.si/?lang=en>).



ARSIMI



Jesenice

KOPSHTI:

Vrtec Jesenice, Cesta Cirila Tavčarja 21, 4270 Jesenice

🌐 (04) 583 6740, www.vrtecjesenice.si

ARSIMI FILLOR:

OŠ Toneta Čufarja Jesenice, Cesta Cirila Tavčarja 21, 4270 Jesenice

🌐 (04) 583 3250, www.tonecufar.si

OŠ Prežihovega Voranca Jesenice, Cesta Toneta Tomšiča 5, 4270 Jesenice

🌐 (04) 581 1500, www.prezihovvoranc.si

OŠ Koroška Bela Jesenice, Cesta talcev 2, 4270 Jesenice

🌐 (04) 580 6405, www.oskoroskabela.si

OŠ Poldeta Stražišarja, Ul. Viktorja Kejžarja 35, 4270 Jesenice

(programe edukative për fëmijët me nevojë të veçantë)

🌐 (04) 583 4150, www.poldestrazisar.si

ARSIMI I MESËM:

Srednja šola Jesenice, Ulica bratov Rupar 2, 4270 Jesenice

🌐 (04) 581 3100, www.ssj-jesenice.si

Gimnazija Jesenice, Trg Toneta Čufarja 1, 4270 Jesenice

🌐 (04) 580 9450, www.gimjes.si

ARSIMI PËR TË RRITUR:

Univerziteti Popullor / Ljudska univerza Jesenice

Delavska ulica 1, 4270 Jesenice

🌐 (04) 583 3802, www.lu-jesenice.net/splosno-izobrazevanje



PUNËSIMI

Aplikimi për leje pune përfshihet te aplikimi për një leje të vetme pune dhe qëndrimi, çka u mundëson shtetasve të huaj nga vende të treta të hyjnë, jetojnë dhe punojnë në Slloveni. Aplikimi për një leje të vetme duhet të dorëzohet pranë njësisë administrative nëse jeni tashmë të regjistruar në Slloveni ose pranë konsullatës apo ambasadës sllovene në vendin tuaj. Përpara dorëzimit të aplikimit, sigurohuni të njoftoni punëmarrësin, pasi ata duhet të sigurohen se detyrimet e taksave janë paguar plotësisht në ditën e aplikimit.

Procedura për lëshimin e lejes menaxhohet nga njësia administrative, ndërsa aprovimi lëshohet nga shërbimi i punësimit, me kusht që ju t'i plotësoni kushtet e kërkuara. Kushtet ndryshojnë në varësi të llojit të punës. Për më shumë informacione mund të vizitoni Shërbimin e punësimit dhe faqen e internetit: https://www.ess.gov.si/delodajalci/zaposlovanje_in_delo_tujcev/vrste_soglasij_in_pogoji.

Lejet e punës për qytetarë nga Bosnje-Hercegovina dhe qytetarë të Serbisë, si edhe punët sezonale në agrikulturë, që zgjasin më shumë se 90 ditë lëshohen nga shërbimi i punësimit.

Vetëpunësimi: Qytetarët me kombësi të huaj mund të vetë-punësohen pas 1 viti qëndrimi ligjor të pashkëputur në Slloveni ose pas regjistrimit në regjistrin e biznesit. Në këtë rast, nuk është i nevojshëm aprovimi nga Shërbimi i Punësimit.

Për t'u informuar më shumë mbi të drejtat dhe detyrimet tuaja dhe të punëdhënësit tuaj, kontaktoni qendrën e këshillimit për punëtorët "Delavska svetovalnica" duke telefonuar në numrin pa pagesë 080 14 34 ose duke vizituar faqen e internetit: <http://www.delavskasvetovalnica.si>.



Jesenice

Shërbimi i punësimit i Republikës së Sllovenisë / Zavod RS za zaposlovanje,
Urad za delo Jesenice

Cesta maršala Tita 16, 4270 Jesenice

☎️ (04) 581 1300, www.ess.gov.si/o_zrsz/naslovi_in_uradne_ure/

SPORTE, KULTURË DHE JETË SOCIALE

Aktivitetet zbavitëse janë shumë të rëndësishme për mirë-qenien tuaj në një mjedis të ri. Pse të mos bashkoheni në një aktivitet të qytetit dhe të njiheni me vendasit? Shumica e tyre janë falas dhe organizatorët janë gjithmonë të lumtur të takojnë pjesëmarrës të rinj. Për detaje, kontakto direkt secilën organizatë.

Aktivite sportive: Aktivitetet sportive janë pjesë e klubeve sportive. Hidhuni një sy adresave të mëposhtme edhe atyre në internet, për të parë se çfarë është e disponueshme në qytetin tuaj. Me siguri do të ketë një skuadër futbollit, basketbollit, hendbollit dhe volejbollit ku mund të bëheni pjesë, po ashtu edhe klub alpinizmi, që do t'ju njohë me kodrat rreth e për qark, në mënyrë që të eksploroni shtëpinë tuaj të re.

Aktivite kulturore: Nëse preferoni kulturën në vend të sporteve, mund të vizitoni një muze ose një galeri në qytet, të vizitoni një ekspozitë ose të bëheni pjesë e shoqërisë kulturore lokale për të ndarë pikëpamjet me anëtarët e tjerë.

Qendrat rinore ofrojnë një vend për nxënësit e gjimnazeve, për studentët e universitetit dhe të rinj të tjerë për t'u takuar dhe shoqëruar. Qendrat organizojnë aktivitete sociale dhe kulturore, aktivitete sportive dhe aktivitete edukative jo formale (seminare, kurse, fjalime, diskutime në tryezë të rrumbullakët).

Bibliotekat janë një thesar informacioni për aktivitetet në zonën tuaj, ndaj ndaloni në bibliotekën e zonës dhe interesohuni për aktivitetet e ardhshme. Gjithashtu, bibliotekat organizojnë shpesh herë aktivitete për fëmijët e kopshtit dhe të shkollave.



SPORTE, KULTURË DHE JETË SOCIALE

Jesenice

Univerziteti popullor / Ljudska univerza Jesenice, Veçgeneracijski center
Gorenjske
Delavska ulica 1, 4270 Jesenice

🌐 (04) 583 3802, www.lu-jesenice.net/splosno-izobrazevanje/vecgeneracijski-center

Univerziteti popullor i Jesenice-s ofron aktivitete të ndryshme, që do t'ju ndihmojnë të integroheni në shoqëri. Mund të zgjidhni mes kurseve të gjuhës slovene dhe të huaja, seminare ICT-je, seminare kreative dhe gatimi. Aktivitet janë të hapura për të gjithë të huajt dhe për slovenët, dhe janë pa pagesë. Fëmijëve u ofrohet ndihmë falas për mësimet.

Shoqëria UP Jesenice / Društvo UP Jesenice
Cesta maršala Tita 63, 4270 Jesenice

🌐 031 569 340, www.up-jesenice.org

Shoqëria humanitare e bamirësisë UP Jesenice në Shtëpinë e Lumturisë (Hiša sreče) ofron aktivitete të ndryshme për zbavitje cilësore në kohën e lirë për të gjitha moshat. Mund të merrni pjesë në seminare kreative, në seminare zejtarie, fjalime, kurse kompjuterike dhe media sociale, ose stërvitje. Shumica e aktiviteteve është falas.

Instituti i sporteve Jesenice / Zavod za šport Jesenice
Ledarska ulica 4, 4270 Jesenice

🌐 (04) 588 4660, 040 666 933, www.zsport-jesenice.si

Shoqëria e sporteve dhe rekreacionit Partizan / Društvo za športno rekreacijo in telesno vzgojo

Cesta Železarjev 1, 4270 Jesenice

🌐 059 110 129, www.partizan-jesenice.si

Shoqëria e sporteve dhe rekreacionit Partizan organizon një sërë kursesh stërvitjeje për fëmijë dhe të rritur në nivele të ndryshme, nga ato të rekreacionit deri te ato konkurruese. Mund t'i bashkoheni në aerobi, stërvitje të shëndetshme, akrobatikë, judo, mazhoretë dhe shumë aktivitete të tjera.

Qendra rinore Jesenice / Mladinski center Jesenice
Ulica Viktorja Kejžarja 22, 4270 Jesenice

🌐 (04) 588 4681, www.mc-jesenice.si

Qendra rinore Jesenice organizon dhe ofron aktivitetet e mëposhtme:

- mundësi të përditshme për të rinjtë për t'u takuar dhe shoqëruar,
- aktivitete festash për fëmijë dhe adoleshentë në vende të ndryshme,
- informacion në fusha të ndryshme me interes për të rinjtë,
- programe parandaluese për të rinjtë me varësi dhe me sjellje të rrezikshme,
- arsim jo formal dhe mundësi për risi dhe kreativitet kulturor për moshat e reja.

Nëse jeni i interesuar të zbuloni kulturën e pasur të Bosnjës, Maqedonisë së Veriut ose Serbisë me në qendër folklorin, letërsinë dhe muzikën, vizitoni shoqëritë e mëposhtme dhe interesohuni për aktivitetet e ardhshme.

Shoqëria kulturore dhe sportive Biser / Kulturno in športno društvo Biser Jesenice

Ledarska 4, 4270 Jesenice

🌐 040 422 077, <http://sokultura.si/wp/povezave/kulturna-drustva/kulturno-in-sportno-drustvo-bosnjakov-biser-jesenice/>

Shoqëria e kulturës maqedonase Ilinden / Makedonsko kulturno društvo Ilinden Jesenice

Cesta Borisa Kidriča 2, 4270 Jesenice

📞 051 239 139

Shoqëria humanitare e sporteve dhe kulturës Vuk Karadžić / Kulturno prosvetno športno in humanitarno društvo Vuk Karadžić Radovljica – podružnica Jesenice

Cesta maršala Tita 62, 4270 Jesenice

📞 040 652 484



KURSE TË GJUHËS SLOVENE

Mësimi i slovenishtes sigurisht do t'ua bëjë jetën më të lehtë në një mjedis të ri. Qytetarët e vendeve të treta (të të gjitha vendeve me përjashtim të shteteve anëtare BE-së të Zonës Ekonomike Evropiane dhe Zvicrës) mund të përfitojnë nga kursi falas i gjuhës slovene i organizuar si pjesë e programit fillestar të integritit të imigrantëve (Začetna integracija priseljencev, ZIP). Kurset organizohen në të gjithë Slloveninë. Të dhënat e kontaktit të ofruesit jepen më poshtë. Lista e plotë e përditësuar gjendet këtu:

<https://infotujci.si/vkljucevanje-v-slovensko-druzbo/brezplacni-tecaji-slovenskega-jezika/>.

Ju mund të merrni pjesë në kurs nëse keni një leje të vlefshme qëndrimi, nuk e keni përfunduar ose nuk jeni të regjistruar në një program arsimor në Slloveni, dhe nuk e keni kaluar ende provimin e nivelit bazë të gjuhës slovene. Kursi ka deri në 180 orë. Për të marrë pjesë, do t'ju duhet një certifikatë nga njësia administrative (Certifikata e përmbushjes së kriterëve të regjistrimit – Potrdilo o izpolnjevanju pogojev za udeležbo v enotnem programu), e cila kushton 22,60 euro. Kusht për t'u futur në provim është pjesëmarrja në 80% të orëve. Provimet janë pa pagesë.

Përveç këtyre kurseve, ju gjithashtu mund të merrni pjesë në aktivitete të tjera që synojnë të përmirësojnë aftësitë tuaja të gjuhës slovene. Pyesni ofruesin në qytetin tuaj për më shumë informacion.

Kurse falas të gjuhës slovene si pjesë e ZIP, programit të integritit fillestar të imigrantëve në Jesenice, ofrohen nga Univerziteti Popullor Škofja Loka.

Univerziteti Popullor / Ljudska univerza Škofja Loka
Podlubnik 1a, 4220 Škofja Loka

🌐 (04) 506 1300, www.lu-skofjaloka.si

Jesenice

Univerziteti Popullor i Jesenice-s zhvillon kurse me biseda të quajtura “Kako se že to reče?” (“Cila është fjala e duhur për atë?”) dhe kurset me disa nivele të slovenishtes.

Univerziteti Popullor / Ljudska univerza Jesenice

🌐 Delavska ulica 1, 4270 Jesenice
(04) 583 3802, www.lu-jesenice.net

NDIHMË PËR KOMUNIKIMIN

Nëse ju nevojitet ndihmë për të komunikuar me zyrtarët, mësuesit, mjekët ose shoqërinë në përgjithësi, mund të përfitonit nga një ndërmjetës ndërkulturore. Ndërmjetësit flasin anglisht, arabisht, farsisht, farsisht dari, shqip dhe boshnjakisht. Për t'u lidhur me ndërmjetësin më të afërt, ju lutemi kontaktoni shoqërinë "Up Jesenice".

Nëse ju nevojitet ndihmë për të komunikuar dhe flisni shqip, maqedonisht ose boshnjakisht, mund të kontaktoni edhe znj. Resnija Ređepi në "Universiteti Popullor" Jesenice.



Më shumë informacione për integrimin në shoqërinë sllovene mund të gjeni në

<https://infotujci.si/>

(vetëm në gjuhën sllovene dhe gjuhën angleze).

Shoqërinë UP Jesenice / Društvo UP Jesenice
Cesta Maršala Tita 63, 4270 Jesenice

☎ 031 569 340, email: info@up-jesenice.org

Resnija Ređepi, Jesenice Public Education Centre / Ljudska univerza Jesenice,

☎ (04) 5833 803, email: resnija.redepi@lu-jesenice.net

POLICIA, ZJARRFIKËSIT, SHËRBIMI I URGJENCËS

Nëse gjendeni në një situatë ku jeta juaj ose e dikujt tjetër është në rrezik, telefononi në 112 (shërbimi i urgjencës, zjarrfikësit, policia).

Nëse jeni viktimë e një krimi, nëse keni qenë të pranishëm gjatë një krimi ose mendoni se është kryer një vepër penale, telefononi policinë në numrin 113.

Ju gjithashtu mund të telefononi në mënyrë anonime te numri pa pagesë 080 1200.



Jesenice

Stacioni i policisë / Policijska postaja Jesenice

Hrušica 217, 4276 Hrušica



(04) 582 1300, www.policija.si

www.policija.si/o-slovenski-policiji/organiziranost/policijske-uprave/pu-kranj/enote

Shoqata e zjarrfikësve / Gasilska zveza Jesenice

Cesta Maršala Tita 66, 4270 Jesenice



(04) 583 4967, www.gzj.si

Urgjenca / Urgentna ambulanta

Cesta maršala Tita 78, 4270 Jesenice



(04) 586 8385, www.sb-je.si, www.zd-jesenice.si

Autorët:

Kjo broshurë informuese për emigrantët u përpilua nga Instituti i Planifikimit Urban i Republikës së Sllovenisë, si partner i projektit PlurAlps, dhe nga Qendra për Informimin, Bashkëpunimin dhe Zhvillimin e OJF-ve (CNVOS), si nënkontraktore për bashkëpunimet e mëposhtme në zonat pilote:

- Jesenice: Občina Jesenice, Center za socialno delo Gorenjska, Enota Jesenice, Ljudska univerza Jesenice in Društvo UP Jesenice.
- Kamnik: Občina Kamnik, Knjižnica Franceta Balantiča Kamnik, Zasebni vrtec Zarja, Center za socialno delo Osrednja Slovenija, Enota Kamnik, Javni zavod Cene Štupar – Center za izobraževanje Ljubljana.
- Postojna: Občina Postojna, Srednja gozdarska in lesarska šola, BOREO Regijsko stičišče NVO, Center za socialno delo Primorsko Notranjska, Enota Postojna.

Fotografitë nga: arkivat e pjesëmarrësve

Lëshuar nga: Urbanistični inštitut Republike Slovenije

Dizajni, faqosja dhe printimi: SCHWARZ PRINT d.o.o.

Numri i kopjeve: 1.200 kopje

Kopje falas

Lubjanë, tetor 2019





Kjo broshurë informuese për emigrantët u përpilua nga projekti **PlurAlps: Forcimi i kapaciteteve për një hapësirë alpine pluraliste**, (11/2016 – 10/2019) si pjesë e aktiviteteve pilot nën “Paketën e punës 3”: Oferta dhe shërbime të reja për emigrantët. Informacioni për emigrantët u përpilua për zonat pilot të projektit **PlurAlps**, konkretisht për Jesenice, Kamnik dhe Postojna. Ai ofrohet në katër gjuhë: në shqip, anglisht, maqedonisht dhe boshnjakisht.

Për më shumë informacion rreth projektit PlurAlps, ju lutem vizitoni

www.alpine-space.eu/pluralps



Projekti **PlurAlps** bashkëfinancohet nga “Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal” përmes programit “Interreg Alpine Space”.